



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë më, 19.4.2022, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Akti normativ nr. 5 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”” (*Komision përgjegjës*).

2. Akti normativ nr. 8, datë 25.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”” (*Komision përgjegjës*).

3. Akti normativ nr. 7, datë 18.3.2022 “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg” (*Komision për dhënie mendimi*).

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Laert Duraj, Fadil Nasufi, Tatiana Piro, Luljeta Bozo, Ismet Beqiraj, Anduel Tahiraj, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Benet Beci, Ilir Pendavinji dhe Orinaldo Rakipi.

Mungojnë:

Rahman Rraja, Flamur Hoxha, Fatjon Veizaj, Lefter Gështenja, Zef Hila, Ramadan Likaj, Xhelal Mziu, Agron Duka dhe Nusret Avdulla.

Të ftuar:

Nikolla Lera - Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Zarina Taja – Drejtore e Drejtorisë së Harmonizimit Fiskal në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Idlir Gjata - Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Illir Bejtja – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Ilia Gjermani – Drejtor i Programeve të Zhvillimit në fushën e hidrokarbureve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Dhimitër Kote – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Irfan Tarelli – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Jeta Deda – Drejtore e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

HAPET MBLEDHJA

Arben Pëllumbi – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin. Mbledhjen e filluam me pak vonesë për shkak të një angazhimi tjetër që patën deputetët e maxhorancës.

Sot në rendin e ditës kemi aktin normativ nr. 5 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”” dhe aktin normativ nr. 8, datë 25.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar””. Këto dy akte do t’i diskutojmë bashkërisht, meqenëse janë plotësim i njëri-tjetrit. Ne jemi komision përgjegjës dhe relator është zoti Ismet Beqiraj.

Për shkak të faktit që ne u mblodhëm me vonesë opozita është larguar nga mbledhja dhe nuk është e pranishme.

Për të bërë prezantimin e akteve normative, nr. 5 dhe nr. 8, kemi të ftuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zotin Nikolla Lera dhe zotin Ilir Bejtja, Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Kush dëshiron ta prezantojë?

Fjala për ju, zoti Bejtja.

Ilir Bejtja – Faleminderit!

Ky akt normativ vjen në kushtet e një situatë të veçantë, siç është e përcaktuar edhe në ligjin nr. 8450, neni 7 i tij, i cili u referohet çmimeve të ngritura përtej çdo situatë normale në tregun e hidrokarbureve, por edhe për shkak të kësaj situatë të pakësimit të importeve, kërcënimit të sigurisë të furnizimit nëpër tregje, duke qenë se siguria e furnizimit edhe për sektorin tjetër, atë të biznesit, është po në të njëjtat kushte, pra e kërcënuar. Për pasojë, në respekt të ligjit ekzistues të sektorit të hidrokarbureve nr. 8450, neni 7, ku përcaktohet që Këshilli i Ministrave ka për kompetencë liberalizimin e çmimeve të shitjes me pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit në situatë të veçanta tregu, Këshilli i Ministrave mund të vendosë kufizime të përkohshme, çmime tavan apo dysheme për çmimet e shitjes me pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit. Në këto kushte kur nuk ka detajime të tjera është hartuar ky akt normativ, i cili në nenin 21/1 të tij, në situatë të veçanta dhe në masat përkatëse sqaron se cilat janë këto raste, kur

konsiderohen të tilla për të marrë në konsideratë interesin publik apo edhe furnizimin e sigurimit. Po kështu, përcaktohet edhe kompetenca e shpalljes së saj, e cila mbetet përsëri e Këshillit të Ministrave.

Ndërkohë, neni 21/2 ka përcaktuar bordin si mekanizëm kontrolli dhe monitorimi të një situate të tillë, duke përcaktuar se kush bën pjesë në bord, por edhe përgjegjësitë e bordit.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e bordit në mënyrë të detajuar përcaktohen në nenin 21/3 dhe struktura për monitorimin e zbatimit të vendimeve të bordit është në nenin 21/4, ku kjo kompetencë u jepet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Inspektorit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.

Në nenin 21/5, i cili për shumë prej deputetëve në komisionet e tjera ka qenë neni kyç, pavarësisht se për ne kjo është pjesa teknike e situatës, përcaktohet metodologjia e llogaritjes së çmimit. Në aktin normativ nr. 5 është përcaktuar një metodologji e bazuar në përqindje për përcaktimin e marzhit të fitimit për të justifikuar kostot e bizneseve në nivel shumice dhe pakice, por kjo nuk ishte e përshtatshme si për sa i përket mbulimit të kostove në treg të operatorëve të tregut me shumicë apo me pakicë, edhe për faktin që bazuar në luhatjet e çmimit në tregun ndërkombëtar kjo përqindje ndryshonte në mënyrë shumë të rëndësishme në nivele shumë minimale ose maksimale, pra ndikonte ndjeshëm në çmimin fundor në treg.

Gjithashtu, në nenin 21/6 përcaktohen edhe masa të veçanta administrative, si dhe masat me karakter detyrues. Këto 3 nene janë ndryshuar në aktin normativ nr. 8, duke përcaktuar marzhin në masë absolute që askush të mos fshihet prapa përqindjeve, pra kemi përcaktuar për shumicën 3 lekë marzh dhe për pakicën 12 lekë marzh dhe mbi këto pastaj në fund aplikohet TVSH-ja.

Po kështu, edhe te pjesa e nenit 3 të aktit normativ nr. 8, i cili përcakton masat që ka të drejtë të marrë bordi. Kemi ngelur te masa administrative të heqjes së të drejtës të operimit në treg, duke shmangur pjesën e gjobave, e cila gjithmonë është abuzive.

Në nenin 4, për entet publike, të cilat shpesh dalin në treg për të blerë hidrokarbure në mënyrë të përqendruar për nevojat e tyre, përcaktohet edhe detyrimi që të merret në konsideratë situata e veçantë së bashku me vendimet që merr bordi lidhur me çmimin në fundor.

Këto janë elementet kryesore të këtyre 2 akteve normative ose akti 8, që mbetet akti përfundimtar, i cili reflektohet i gjithi në ligjin nr. 8450, për masa dhe situata të veçanta, por

parashikohet që këto mund të ndodhin gjithmonë prandaj është gjykuar që të jenë të trupëzuara në ligjin nr. 8450.

Ligji është i vitit 1999, bazohet plotësisht në Kushtetutë, në nenin 101 të Kushtetutës, po ashtu merr në konsideratë edhe nenet 11 dhe 116 të Kushtetutës, pra për tregun e lirë dhe kompetencat e Këshillit të Ministrave për të ndërhyrë kur vërehen situata të veçanta, pika 4 e nenit 116 të Kushtetutës.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Bejtja!

Fjalën e ka relatori, zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Faleminderit!

Prezantimi nga zoti Bejtja i të 2 akteve normative nr. 5 dhe nr. 8, sigurisht duke u nisur edhe nga relacioni që unë kam paraqitur, ma lehtëson punën në aspektin e prezantimit dhe të analizës analitike të vetë përmbajtjes së këtyre 2 akteve normative.

Për aktet normative nr. 5 dhe nr. 8 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar” Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin mbështetur në nenet përkatëse të Rregullores (nuk po i citoj), të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në cilësinë e komisionit përgjegjës, sot në mbledhjen e tij merr në shqyrtim në bllok të dy këto akte normative, pikërisht aktin normativ nr. 5, të datës 12.3.2022 dhe të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022 i të njëjtit ligj që ju citova më sipër.

Në cilësinë e relatorit për aktet normativ nr. 5 dhe nr. 8, në zbatim të nenit 38 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ju paraqes vlerësimin e përgjithshëm si më poshtë vijon.

Për aktin normativ nr. 5. Akti normativ është hartuar në përputhje me nenin 101 të Kushtetutës, ku parashikohet e drejta e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte rregullatore në fuqinë e ligjit kur ekziston nevoja dhe urgjenca, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra. Ligjvënësi, edhe pse nuk e ka cituar në relacion, e ka parashikuar herët qysh në ligjin ekzistues me nr. 8450, të vitit 1999 “Për përpunim, transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”, ku në nenin 7 parashikohet se: “Këshilli i Ministrave ka kompetencë liberalizimin e çmimeve të shitjes me pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit në situata të veçanta tregu”. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave mund të vendosë kufizime të përkohshme, çmime tavan apo dysHEME për çmimet e shitjes me pakicë të

nënprodukteve të naftës dhe të gazit mbi bazën e të cilave janë derivuar edhe dy aktet që ne po diskutojmë sot.

Rritja e çmimeve të produkteve dhe nënprodukteve të naftës dhe të gazit në tregun ndërkombëtar, për rrjedhojë edhe në tregun shqiptar, krijon një sërë problematikash, të cilat afektojnë normalitetin në vend, duke krijuar kështu një situatë të veçantë. Me qëllim adresimin e kësaj situatë doli si domosdoshmëri ndërhyrja në tregtimin e karburanteve në vend. Kjo ndërhyrje për shkak të emergjencës u realizua nëpërmjet këtij akti normativ, i cili ka për qëllim zgjidhjen e problematikave të krijuara nga rritja e çmimeve të produkteve dhe nënprodukteve të naftës dhe të gazit, kryesisht benzinë, gazoil dhe gaz i lëngshëm i naftës, në tregun shqiptar të ndikuara dhe të varura plotësisht nga tregu ndërkombëtar në kushtet kur në Shqipëri nuk funksionon industria e përpunimit të naftës, sidomos ajo e përpunimit të thellë.

Gjithashtu, ky akt normativ ka për objektivi përcaktimin e masave të veçanta me karakter administrativ dhe detyrues që do të merren ndaj subjekteve, të cilat aktualisht janë marrë, publike ose private, vendase ose të huaja, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës gazit dhe nënprodukteve të tyre. Gjatë të gjithë kohës së kësaj situatë të veçantë në tregun shqiptar, hartimi dhe miratimi i këtij akti normativ nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projekteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2022 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Kjo ka ardhur si rezultat i situatës aktuale të krijuar për shkak të rritjes së çmimeve të produkteve dhe nënprodukteve të naftës dhe gazit në tregun e brendshëm. Ky projekt akt normativ nuk cenon përafrimin në legjislacionet e BE-së, gjithashtu, ky akt normativ nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit sikurse parashkruhet edhe në relacionet bashkëshoqëruese.

Projektligji ose projektakti normativ nr. 5 përbëhet nga tri nene. Në nenin 1 tyre parashikohet që pas kreut e 8 të ligjit ekzistues nr. 8450 të ndryshuar të shtohet kreu 3/1 me 11 dispozita, ose nga neni 21/1 deri te neni 21 /11, duke iu referuar edhe shtimit normal të neneve në ligjin ekzistues, ku jepen parashikimet lidhur me situata të veçanta dhe masat përkatëse si vijon:

Parashikimet kryesore të aktit normativ që po shqyrtojmë janë: situata e veçantë ku është e përkufizuar dhe kushtet që krijojnë situatën e veçantë, për të cilat unë nuk do të ndalem, sepse këtë pjesë ma lehtësoi parafolësi, zoti Bejtja, kur analizoi edhe nenet përkatëse, Bordi i Transparencës dhe kufizimi i përkohshëm i çmimeve të tregtimit me shumicë dhe pakicë të

produkteve të naftës dhe gazit, kompetencat dhe përgjegjësitë e bordit, strukturat për monitorimin e zbatimit të vendimeve të bordit, metodologjia e llogaritjes së çmimit, masat e veçanta administrative, masat me karakter detyrues, organet kompetente për dhënien e masave administrative, vendimmarrja nga bordi, kohëzgjatja dhe zbatimi i këtij akti normativ, anikimi ndaj masave administrative.

Unë nuk do të ndalem nen për nen, ose te dispozitat, siç thashë më sipër, nga neni 21/1 deri te neni 21/11, që janë pjesë e aktit normativ numër 5, pasi nuk dua të bie në përsëritje, por do të veçoja si të veçantë të këtij projekt akti, dhe si risi masat e veçanta që merren në këtë situatë të kësaj krize dhe të situatës reale në tregun që është shumë i brishtë dhe me ndryshime të herëpashershme të çmimeve të tregut me pakicë, ku është konsumatori fundor. Sidomos masat me karakter detyrues do t'i quaj risi. Në kuadër të sigurimit të furnizimit të pandërprerë ky akt normativ lejon shoqërinë Albpetrol sh.a që të hyjë në marrëveshje direkte me shoqëri private ose publike dhe kjo përbën një nga risitë themelore të këtij akti normativ, i cili jo vetëm është një valvul garancie energjetike publike dhe me përgjegjësi shtetërore, por besoj dhe shpresoj të jetë edhe një amortizator i fuqishëm real dhe të ndikojë direkt edhe në transparencën publike të tregtimit të këtyre produkteve shumë të rëndësishme për energjetikën dhe xhepat e qytetarëve.

Me hyrjen në fuqi të këtij akti normativ është shpallur edhe situata e veçantë në kuptim të plotë të aktit dhe po zbatohen masa me karakter të veçantë si pasojë e situatës emergjente të tregut hidrokarbur.

Nga ana tjetër për shkak të situatës së krijuar me qëllim mbrojtjen e konsumatorit shqiptar për sa është e mundur e shikoj të nevojshme këtë zgjidhje pavarësisht se prek parimet e lirisë së tregut dhe ju ftoj ta miratojmë atë!

Sa më sipër në cilësinë e relator sugjeroj që komisioni ynë të fillojë shqyrtimin dhe miratimin e këtij projekt akti.

Së dyti, për aktit normativ numër 8, për sa më sipër citova, në këtë akt bëhen disa ndryshime që janë pjesë e aktit normativ numër 5. Konkretisht ndryshohet neni 21/ 5 i kreut të tretë /1 që ka të bëjë me metodologjinë e llogaritjes së çmimit, ku gjatë zbatimit të formulës së propozuar në aktin normativ numër 5, që bazohet në bursën *plaz* të një dite më parë, në kushtet *CIF Med* dhe *premium* prej 20 dollarë për tonë është venë re se për shkak të faktorëve të pasigurisë dhe krizës *premium* i paguar nga importuesit variojnë 60-80 dollarë për tonë mbi çmimin mbi çmimin në kushtet *fobnet*. Formula *CIF Med* është e pa aplikueshme për gazin e

lëngshëm të naftës pasi ky në momentin e arritjes së import është pronë e porositësit dhe për këtë arsye çmimi i tij duhet të përcaktohet sipas faturës së importit. Marzhet e përcaktuara në aktin normativ të mëparshëm 1% për shumicën dhe 5% mbi pakicën mbi çmimin e blerjes së benzinës, gazoilit dhe GLN-së, janë të kundërshtuar nga operatorët e shumicës pakicës pasi konsiderohen se nuk mbulojnë shpenzimet duke çuar në shitje me humbje. Operatorët kanë argumentuar me dokumentacione dhe me lista analitike të gjitha shpenzimet operacionale dhe nivelin e marzhit që nevojitet për mbulimin e tyre dhe për këtë arsye ky akt i ri normativ parashikon që marzhi duhet të jetë në vlerën absolute 15 lekë për litër, 3 lekë për shoqëritë e shitjes me shumicë dhe 12 lekë për shoqëritë e shitjes me pakicë. Ju e keni përpara edhe ligjin përkatës, nenin 2 i aktit normativ numër 8 ku është edhe formula.

Lidhur me masat administrative ku ndërhyt akti numër 8 në ndryshim nga neni 21 /6 i aktit numër 5, i cili për shkeljet e vendimeve të bordit parashikon që gjoba me vlerë 90 milionë lekë për shoqëritë e tregimit me shumicë, dhe 2 milionë lekë për ato të trajtimit me pakicë dhe heje licence në rast përsëritjeje të shkeljes, ky akt normativ, pra akti numër 8, parashikon ndryshime duke propozuar vetëm masa administrative të pezullimit të licencës për tre muaj dhe heqja e saj në rast vazhdimi të veprimtarisë me licencë të pezulluar, si edhe sekuestrim të stacionit të shitjes. Gjithashtu edhe në rast e përsëritjes së shkeljes parashikohet po heqja e licencës së sekuestrimit të stacionit të shitjes. Gjithashtu, shtohen në nenin 27/1, kreu 3, të aktin normativ 5 detyrimi për institucionet shtetërore të cilat gjatë procedurave të prokurimit duhet të mbajnë parasysh këto ndryshime ligjore dhe vendime të herëpashershme të bordit, të cilat merren në funksion të ndryshimeve të çmimeve në tregun ndërkombëtar.

Së katërti, saktësime në procedurat e dhënies së masave administrative ku ndryshohet neni 21 / 8, i aktit normativ numër 5. Në aktin normativ numër 5 Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve konstaton shkelje dhe të drejtat e masave e kishte ndërsa të drejtën e marrjes së masës e kishte Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, ndërsa për heqjejn e licencës e kishte Bordi, ndërsa tani propozohet që masat administrative do të jepen nga bordi, i cili i referohet shkeljeve nga dy institucionet e mësipërme, pra i referohen shkeljeve që janë evidentuar nga dy institucionet e mësipërme.

Së pesti, ankimi ndaj masave administrative, PRA ku ndryshohet neni 21/1 i kreut të tretë/ e i aktit numër 5, ku masat administrative të vendosura sipas këtij kreu ankimohen në

Gjykatën kompetente për shqyrtimin e marrëveshjeve administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ndërsa rreth këtyre akteve kam disa pyetje për propozuesit.

Së pari, kompania publike Albpetrol sh.a ka filluar ose pritet të fillojë së shpejti këtë aktivitet të ri në sektorin hidrokarbur pas 24 vjetësh, që nga viti 1998 kur u shpërbë kompania Albpetrol në tri kompani bija, pasi akti normativ ka hyrë në fuqi pothuajse më miratimin e aktit numër 5 datë 12.03.2022.

Pyetja e dytë, sa për qind të tregut ekzistues ka filluar ose pritet të fillojë së shpejti këtë aktivitet të ri në tregun hidrokarbur?

Së dyti, sa për qind e tregut ekzistues është parashikuar që të mbulojë me furnizime, karburante dhe GLN kompania “Albpetrol” sh.a.?

Pyetja e tretë, angazhimi në këtë aktivitet të ri për kompaninë “Albpetrol” sh.a. kërkon logjistikë dhe infrastrukturë teknike dhe teknologjike, detyrimisht është e shoqëruar edhe me programe financimi për investime në këtë kompani. Në relacionet që shoqërojnë të dyja aktet normative shpreheni se aktet normative nuk kanë efekte financiare në buxhetin e shtetit. Atëherë nga do t'i gjejë burimet financiare kjo kompani?

Pyetja e katërt, a do të ketë lehtësi dhe afate sa më të shkurtra në procedurat e tenderimit kompania “Albpetrol” sh.a., sepse është kompani publike, dhe sigurisht është e detyruar që të respektojë ligjet ekzistuese në fuqi lidhur me tenderimet?

Pyetja e pestë, me rifutjen e kompanisë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e tregimit të nënprodukteve të naftës dhe gazit, si mendoni, cilat do të jenë pritshmëritë në lidhje me nivelin e çmimeve dhe perceptimit të monopolit në tregun e brendshëm?

Pyetja e gjashtë ka të bëjë me transparencën. Si ka rezultuar për rezervat e sigurisë nga institucionet e përgjegjësisë të nënprodukteve të naftës dhe GLN-së, si detyrim ligjor i nenit 9 të ligjit nr. 8450/1999, i ndryshuar dhe akteve normative përkatëse që po shqyrtojmë, sepse janë futur në fuqi këto? A kemi sot rezerva sigurie?

Pyetja e shtatë, sa është përqindja në energjinë totale që konsumojmë në vit, si zë në burimet fosile në naftë dhe në gaz?

Pyetja e fundit që kisha që lidhet edhe me një lajm pozitiv që ne s'kemi, pse të mos e shpërndajmë dhe ta themi që gjatë vizitës së fundit të Kryeministrit në Azerbajxhan, është diskutuar në lidhje me mundësinë e ndërtimit të industrisë së përpunimit të thellë të naftës, që tek

e fundit lidhet direkt me situatën energjetike në treg. Pyetja ime është: cili është mendimi juaj në lidhje me domosdoshmërinë e ringritjes së industrisë së përpunimit të thellë të naftës me burime nafte vendi dhe të importit, pa i neglizhuar këto, ku shteti të zotërojë aksione me peshë, pse jo edhe paketën kryesore të tyre, e parashikuar kjo që në objektivat dhe synimet e projektbuxhetit të parashikohet që tani për projektbuxhetin që ne do të fillojmë ta shqyrtojmë, në mënyrë që të mos të mos vijë një ditë që ne t'i kemi sytë vetëm nga tregjet ndërkombëtare, se mjafton që konsumatorit shqiptar t'i kursejmë vetëm një palë taksa, jo taksat e prodhuesit të nënprodukteve të naftës, është me fitim të madh ekonomik.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi - Faleminderit, zoti Beqiraj!

Në fjalën time, kur bëra prezantimin e të ftuarve lashë pa përmendur që nga Ministria e Infrastrukturës kemi të ftuar edhe zotin Ilia Gjermani, drejtor i Programit të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve dhe nga Ministria e Financave, zotin Ildir Gjata, këshilltar në ministri.

Kërkoj ndjesë!

Zoti Bejtja, do t'i përgjigjeni ju pyetjeve të relatores?

Ilir Bejtja – Pyetja e parë për Albpetrol-in, potencialisht e drejta e Albpetrol-it është përcaktuar në ligj, pasi nuk ka pasur të drejtë t'i kryejë më parë këto aktivitete, por ka qenë i fokusuar vetëm në procesin e nxjerrjes dhe shitjes së naftës bruto dhe i është dhënë mundësia që, nëpërmjet ligjit nr. 8450 të ketë aktivitet tregtar të produkteve dhe nënprodukteve të naftës.

Sa për qind të tregut do të zërë, këtë ne nuk e dimë, sepse nuk dimë çfarë angazhimi do të mund të ketë shteti nëpërmjet Albpetrol-it, që të luajë rol në tregun e naftës. Kjo është e dhënë vetëm potencialisht si mundësi, pra nesër nëse ngelemi në dorë të kapitaleve private, do të mundej që shteti të dilte dhe të blinte nëpërmjet Albpetrol-it, me injektim kapital a nuk e di si, karburante për tregun e karburanteve.

Kemi parasysh këtu, që më parë duhet të jetë harxhuar totalisht rezerva e sigurisë, e cila është 90 ditë tregu që pak më poshtë do t'ju tregoj nëse ekziston apo jo.

Albpetroli i ka këto mundësi, thashë është një kompani shtetërore, ku sot për sot, aktiviteti i tyre është menaxhimi i fushave të naftës, të cilat nuk janë nën koncesion për prodhim të naftës bruto apo të gazit. Në rastin konkret i është dhënë mundësia që të ketë edhe këto aktivitete, varet vetëm nga rritja e kapitalit me injektim nga ana e shtetit. Vetë Albpetrol-i sot me

mundësitë që ka s'mund të fillojë menjëherë një aktivitet dhe të jetë aktor themelor në treg, nëse nuk do të kishte rritje të kapitalit të tij.

Afatet e tenderimit nuk luajnë rol. Bordi nuk përcakton kushtet e tenderimit, por përcakton një çmim maksimal, duke iu referuar formulës që është e përcaktuar në aktin normativ nr. 8, që mund të shitet grupi i tri karburanteve, pra gazi i lëngshëm i naftës, benzina dhe diesel-i, të cilat janë edhe produktet kryesore që konsumohen në treg nga konsumatorët fundorë. Në këtë aspekt ne monitorojmë, nëpërmjet mekanizmave të tregut, pra të bursës dhe atyre shtetërore, që është Drejtorja e Doganave dhe Inspektorati Shtetëror i Monitorimit të Tregut, sa e pastër dhe sa e saktë është sjellja e operatorëve në këtë treg, pra as nuk e cenojmë konkurrencën e lirë e asgjë. Nëse dikush ka mundësi që të shesë më lirë dhe të zërë më tepër pjesë në treg, këtë gjë e ka në çdo moment.

Është bërë një ndarje midis marzhit të pikave të shumicës dhe pakicës, sepse një pjesë e mirë e shitësve me pakicë, nuk janë pjesë e zinxhirëve të mëdhenj të kompanive të mëdha që e plotësojnë komplet zinxhirin e tregut, pra nga furnizimi me shumicë deri te shitja me pakicë. Për pasojë duhet t'u jepej edhe atyre një mekanizëm garancie për mbulimin e shpenzimeve të tyre si biznese pakice. Kjo u bë, sepse u vu re një mbyllje masive e disa pikave të karburanteve, të cilat nuk janë pjesë e zinxhirëve konvencionalë.

Si do t'i ketë çmimet Albpetrol-i? Do të jenë çmime tregu, nëse diskutojmë që të futet Albpetrol-i futet thjesht në kuptimin e garantuesit të sigurisë së furnizimit. Askush nuk thotë që Albpetrol-i do të shesë me humbje. Asnjë ndërmarrje shqiptare, pavarësisht se me 100% aksione shtetërore, nuk mund të ekzistojë duke shitur me humbje, nëse shet si e tillë, mund ta bëjë këtë vetëm 3 vjet, sipas ligjit të falimentit, duhet ta deklarojë falimentin dhe më pas menjëherë kalon në likuidim. Pra nuk ekziston një ndërmarrje, e cila nuk garanton aktivitetin e saj me të ardhura, ndryshe do të duhet të injektohet vazhdimisht për humbjet nga shteti.

A monitorohet rezerva? Si t'ju them! Unë firmos gati 3 ose 4 kontrole çdo javë për inspektimin e rezervave, të cilat kryesohen nga zoti Gjermani, dhe kanë edhe pjesëmarrjen e Inspektoratit Shtetëror Teknik, pra monitorohen rregullisht. Rezervën, sa herë që e kemi kontrolluar e kemi gjetur në vend, dhe kur nuk e kemi gjetur, kemi aplikuar të gjitha mekanizmat detyrues që ka ligji shqiptar, si ato që rregullojnë aktivitetin e Inspektoratit Shtetëror Teknik, edhe ato që i përgjigjen ligjit nr. 8450.

Sa përqind e energjisë është e mbuluar nga karburantet, ishte pyetja tjetër. Diku te 60% në total, sepse energjia tjetër, mbulohej nga energjia elektrike rreth 38% e saj, por ekzaktësisht nga diesel-i, GLN-ja dhe benzina janë 58%, pjesa tjetër janë karburante të tjera.

Pyetja për rafinerinë nëse do të jetë shtetërore, në çdo lloj rasti, apo private, vendimi i takon qeverisë nëse do të hapë një sipërmarrje të re me 100% aksione shtetërore për të ndërtuar një rafineri, e cila do të operojë në kushtet e tregut. Pra nuk ka fare rëndësi nëse e ngrenë privatët apo do ta ngrejë shteti, rafineria do të shesë si në treg, do e blejë naftën në treg nga prodhues që janë që të gjithë privatë. Albpetrol-i prodhon shumë pak për të mbështetur një rafineri që të ekzistojë në treg, prodhimi i Albpetrolit nuk i kalon 220 tonë në ditë, pra nuk justifikon mbështetjen e një rafinerie me naftë. Patjetër që nafta për t'u përpunuar do të vijë nga tregu i brendshëm dhe ai ndërkombëtar dhe si e tillë do të silltet në kushtet e tregut. Pra, e ka shteti apo e ka privati, përveç faktit që rritet totali i investimeve në vend, hapen disa vende të reja pune, krijohet edhe një faktor tjetër prodhimi i hidrokarbureve në vend. Pra zinxhiri i vlerës në industrinë e kromit, shton vlerën e shtuar të produkteve të përpunuara në vend, por nuk është se sjell ndonjë risi në treg. Mund t'ju sjell një shembull, kompania e gazit më e madhe në botë është holandeze, e cila ka rreth 63% të volumit të trajtimit të gazit natyror në të gjithë Europën dhe është e gjitha 100% me aksione shtetërore dhe unë nuk di që ato të shesin ndonjëherë në treg në mënyrë të tillë që të mbrojnë konsumatorët, shesin në bursë dhe sa kohë që shitet në bursë, sa kohë që shitet në treg të parregulluar, garantohet konkurrenca e lirë dhe gara midis bizneseve për të mos pasur situata monopol ose oligopol. Këtë e monitorojmë si shtet. Organizimi i bizneseve në dëm të konsumatorëve është i ndaluar si me legjislacionin evropian, po ashtu edhe me atë shqiptar. Këtë e kontrollon Autoriteti i Konkurrencës. Këto ishin përgjigjet e pyetjeve.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Atëherë hedhim në votim aktin nr. 5, datë 12.03.2022 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar””.

Kush është dakord me këtë akt normativ? Kundër? Nuk ka? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim aktin normativ nr. 8, datë 25.03.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar””.

Kush është dakord me këtë akt normativ? Kundër? Nuk ka? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, zoti Bejtja, zoti Gjermani, zoti Lera dhe zoti Xhata.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.04.2022, ora 11:10

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Akti normativ nr. 7, datë 18.3.2022 “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”. (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Laert Duraj, Fadil Nasufi, Tatiana Piro, Luljeta Bozo, Ismet Beqiraj, Anduel Tahiraj, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Benet Beci, Ilir Pendavinji dhe Orinaldo Rakipi.

Mungojnë:

Rrahman Rraja, Flamur Hoxha, Fatjon Veizaj, Lefter Gështenja, Zef Hila, Ramadan Likaj, Xhelal Mziu, Agron Duka dhe Nusret Avdulla.

Të ftuar:

Nikolla Lera – Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Idlir Gjata – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arjana Dyrmishi – Drejtoreshë e Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Dhimitër Kote – Zëvendësministër Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Irfan Tarelli – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Jeta Deda – Drejtore e Përgjithshme, AKU

HAPET MBLEDHJA

Arben Pëllumbi – Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, tek akti normativ nr. 7, datë 18.03.2022 “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kemi të ftuar zotin Nikolla Lera, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, zotin Ildir Gjata, këshilltar në ministri, dhe zonjën Arjana Dyrmishi.

Mirë se erdhët!

Nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kemi të ftuar zotin Dhimitër Kote, zëvendësministër, zotin Irfan Tarelli, drejtor i Përgjithshëm, dhe zonjën Jeta Deda, drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Ushqimit.

Mirë se erdhët!

Kush dëshiron të bëjë prezantimin për aktin nr.7?

Fjala për ju, zoti Kote.

Dhimitër Kote – Ju jeni njohur me këtë akt dhe materialet i keni përpara.

Për sa i përket transparencës dhe monitorimit të çmimeve për disa produkte ushqimore bazë dhe të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg, mendoj se ky komision ka funksionuar, ka kontrolluar dhe ka bërë një analizë të qartë të çmimeve për të ruajtur dhe për të pasur nën kontroll marzhin e fitimit të kompanive, por edhe të gjithë aktivitetit që krijon çdo kompani për këto produkte. Në të gjitha vendimet e marra, analiza e produktit është bërë që me hyrjen në doganë, kontrollohet se sa është kostoja në të gjithë procesin e çdo produkti dhe sa është marzhi i fitimit, pa prekur kompaninë për sa i përket problemit të kostos operacionale që duhet për çdo produkt. Kjo tregon qartë se mbron abuzimin dhe krijimin e një problemi për sa i përket psikologjisë së konsumatorit. Pra, konsumatori nuk është vetëm në këtë rast, por është i mbrojtur dhe ne si institucione, tatimet dhe i gjithë grupi që merret me këtë gjë, e kemi këtë situatë nën kontroll. Çmimi i produkteve ndryshon, nuk është stabil, por është një çmim që është nën kontroll, sipas lëvizjes që i bëhet këtij produktin në bursë dhe në treg.

E gjithë kjo punë është bërë me transparencë, në bashkëpunim me të gjitha kompanitë, nën kontrollet e vazhdueshme që kanë bërë tatimet, AKU-ja dhe të gjitha institucionet tona, për

të verifikuar dhe për të mbajtur nën kontroll produktet kryesore të shportës, që furnizojnë qytetarët tanë.

Për anën teknike kemi Nikon, Jetën apo Irfanin, të cilët mund t'i marrin në analizë të gjitha dhe mund t'i diskutojnë nën nën ose në parim.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Kote!

Fjala për relatorin, Fadil Nasufi.

Fadil Nasufi – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj edhe përfaqësuesit e ministrive!

Në fakt, ky akt është në vazhdim të pikës së parë të rendit të ditës, aktit normativ nr. 5, sepse bëjnë pjesë në paketën e “rezistencës sociale”, që ka të bëjë me një situatë të veçantë të krijuar në treg. Kjo është një fushë e ndjeshme, sepse ka të bëjë me transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg. Pra, situata tregon se ky akt, i cili ka filluar me zbatimin dhe ne jemi sot prezent me fuqi legislative, diktohet nga agresioni rus në Ukrainë, diktohet nga problematikat që kanë tregjet ndërkombëtare në lidhje me furnizimin e këtyre artikujve bazë, ka të bëjë me një sinjal jo shumë pozitiv me rezervat e produkteve të origjinës, që ne diktojmë nga importi.

Qeveria, nëpërmjet këtij akti, është shprehur për kufizimin, për një kohë të përkohshme, e çmimit të këtyre produkteve, për të kontrolluar marzhin e fitimit dhe për të monitoruar të gjithë ecurinë që nga furnizuesit, supermarketet dhe furnizuesit me shumicë deri te konsumatori.

Në projektakt është përcaktuar roli, funksioni dhe përbërja e bordit, si dhe masat përkatëse, që faktikisht kanë filluar të japin efektet e tyre të monitorimit në treg të kësaj situatë, për të cilën ne japim dakordësinë tonë që të miratohet në seancën plenare të radhës, në mënyrë që të japë efekte pozitive e të ulët sa më shumë kostoja e kësaj krize, të cilën kemi filluar ta monitorojmë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Urojmë që të ketë efekt sa më të shkurtër, me qëllim që situata e furnizimit dhe e qenies në normalitet të këtyre produkteve të jetë në kushte normale, siç ka qenë përpara se të na e diktonte kjo situatë.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Nasufi!

A ka pyetje apo diskutime nga kolegët? Nuk ka.

Akti normativ nr. 7, ashtu si dhe dy aktet e tjera, nr. 5 dhe nr. 8, që sapo kaluam, janë një veprim i qeverisë shqiptare me forcën e ligjit, të cilën po e shqyrtojmë sot për ta kthyer në ligj.

Duke pasur parasysh ndërhyrjen brutale dhe të paprecedentë të Rusisë ndaj Ukrainësi në tregjet e hidrokarbureve, ashtu edhe në tregun e produkteve bazë ushqimore është krijuar një pësjtjellim i shoqëruar me rritje çmimesh. Në këto kushte, kushte të emergjencës, aprovohen këto akte normative, në mënyrë që të mund të asistojmë, sa më shumë që të jetë e mundur, qytetarët tanë për ta bërë sa më pak të ndjeshme këtë situatë, e cila, pavarësisht se lufta zhvillohet larg kufijve tanë, na ka prekur të gjithëve në përditshmërinë e jetës sonë.

Kush është dakord me aktin normativ nr.7? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Mbledhjen tjetër e kemi nesër në orën 10:00.

Mbledhja mbyllet.

MBLEDHJA MBYLLET